



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.
_____._____.2020

Burrel, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “**RUÇI**” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **K37509982G**

Adresa: Diber, Burrel, Lagjja “Partizani”, Sheshi “Demokracia”, Zona kadastrale nr.1326, Nr. i pasurise 3/6/ND.

Procedura e prokurimit: “**E Hapur - Mallra**”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-54918-03-25-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje Naftë (D1)**”, me fond limit: **9 555 840** (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) **lekë pa TVSH**, nga grandi në vlerën: **8 952 750** (tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat në vlerën: **603 090** (gjashtëqind e tre mijë e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi: **nga data e nënshkrimit të kontratës, deri më datë 31.12.2020.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 17 datë 30 Mars 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “**RUÇI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K37509982G**

Vlera: **9 555 840** (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) **lekë pa TVSH**

Marzhi i fitimit i shprehur në përqindje është **14%** (katërmëdhjetë përqind)

2. Operatorin Ekonomik: “**JUGEN-06**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L88327902T**

Vlera: **9 555 840** (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) **lekë pa TVSH**

Marzhi i fitimit i shprehur në përqindje është **4%** (katër përqind)

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “JUGEN-06” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L88327902T**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “JUGEN-06” Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bilancet e paraqitura të tre viteve të mëparshme, përkatësisht të vitit 2017, 2018 dhe 2019 janë të pakonfirmuara nga administrata tatimore.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.2 Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, lëshuar nga administrata tatimore, ku të vërtetohet se xhironja mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më e vogël se 40 % e fondit limit

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në vërtetimin e xhiros të paraqitur nuk jepet informacion për xhiron e vitit 2017.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme :

a) Në rastet e furnizimeve të ngjashme të kryera me institucione shtetërore.

- Vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës ku në vërtetim të jetë e përcaktuar koha e furnizimit, vlera e realizuar si dhe vërtetim e realizimit me sukses të kontratës.

b) Në rastet e furnizimeve të ngjashme me subjektet private.

- Faturat tatimore shitjeje ku të jenë të shënuara saktë datat, mallrat, sasisë, shumat si dhe

emri dhe nënshkrimi i personit blerës.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, Faturat Tatimore Shitje të paraqitura për furnizimet e kryera me subjektin privat, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi, pasi mungon vula te nënshkrimi i shitësit, si dhe në disa prej tyre nuk paraqitet firma e blerësit.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 dhe VKM-së Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk disponon licencë për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve sipas legjislacionit në fuqi.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim “Për Hyrje Dalje në rrugë” për pikën e tregtimit me pakicë të stacionit të shitjes, ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqesë Autorizimin e lëshuar nga Bashkia (e vlefshme).

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk disponon Autorizim “Për Hyrje Dalje në rrugë” për pikën e tregtimit me pakicë të stacionit të shitjes lëshuar nga Bashkia.

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat, vertetur me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj).

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, pika e furnizimit nuk është me vendodhje në Njësinë Administrative Burrel, por në Njësinë Administrative Koms, fshati Burrel/ Bashkisë Mat.

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e

Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2019.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk është paraqitur Vërtetim lëshuar nga ISHTI ku të vërtetohej se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2019.**

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotokopje të deklaratave doganore të produktit të furnizuar gjatë 6 muajve të fundit nga data hapjes së ofertave, për të vërtetuar që është importues/ ose kontratues me një shoqëri importuese për furnizimin e produktit që prokurohet.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk janë paraqitur deklaratat doganore të produktit të furnizuar gjatë 6 muajve të fundit nga data hapjes së ofertave të tij, ose të shoqërisë importuese e kontraktuar nga ana e tij.**

IX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Leje Mjedisore të tipit C, të lëshuar nga QKL, Akt-Teknik të lëshuar nga PMNZH, dhe Policë Sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese jo më pak se 40 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon kapacitet depozituese jo më pak se 40 m³.**

X. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10 pika 1/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacion të shitjes së karburantit me pakicë në pistoletë publike me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, deri në përfundim të Kontratës dhe me vendndodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, në adresën e kërkuar dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur për pronësinë e pikës së stacionit të shitjes së karburantit si dhe vendodhjes së deklaruar në deklaratën për përmbushjen e këtij kushti, konstatohet se, nuk disponon pikë stacion shitje në Njësinë Administrative Burrel të Bashkisë Mat.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“RUÇI”** Sh.p.k, me seli: *Diber, Burrel, Lagjja “Partizani”, Sheshi “Demokracia”, Zona kadastrale nr.1326, Nr. i pasurisë 3/6/ND*, me numër Nipt-i: **K37509982G**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **9 555 840** (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) **lekë pa TVSH**, me Marzh i fitimit i shprehur në përqindje është **14%** (katërmëdhjetë përqind), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **11.05.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR